

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore

Viti 2018


Tiranë, më 24 Prill 2020: Në vitin 2018, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, është rreth 22,4 milionë ton, duke shënuar një rritje me 4,6 %, krahasuar me vitin 2017. Struktura e burimeve të brendshme natyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 49,5 %, “biomasa” 35,6 %, “mineralet metalike” 7,9 % dhe “materialet e energjisë fosile” 7,1 %.

Tab. 1 Burimet e brendshme natyrore

(mijë ton)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Biomasa	7.884,0	7.970,0	8.066,5	8.164,1	7.970,6
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.436,9	1.528,7	1.180,0	1.356,8	1.766,0
Mineralet jo metalike	12.351,1	15.380,5	18.062,5	10.593,3	11.074,6
Materialet fosile të energjisë	1.515,2	1.546,5	1.161,2	1.304,9	1.582,6
Total	23.187,1	26.425,7	28.470,1	21.419,1	22.393,8

Fig.1 Struktura e burimeve të brendshme natyrore



Shuma totale e importit të materialeve mjedisore në vitin 2018 ishte rreth 4,4 milionë ton, e cila krahasuar me vitin 2017 është 4,9 % më e lartë. Pjesën më të madhe e zënë produktet e “biomasës” me 1.465 mijë ton të shoqëruar nga “materialet fosile të energjisë” me 912,6 mijë ton. Më pas kemi produktet minerale jo metalike” me 905,9 mijë ton, “mineralet dhe koncentratet metalike” me 883,6 mijë ton dhe “produkte të tjera” ku përfshihen mbetjet e importuara me 319,1 mijë ton.

Tab. 2 Importet e materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Biomasa	1.242,3	1.233,9	1.369,5	1.378,4	1.465,3
Mineralet dhe koncentratet metalike	782,8	816,9	752,4	829,9	883,6
Mineralet jo metalike	854,3	810,5	770,4	954,9	905,9
Materialet fosile të energjisë	872,1	818,0	891,1	813,0	912,6
Produkte të tjera dhe mbetje të importuara	276,6	266,4	282,2	302,2	319,1
Totali	4.028,1	3.945,7	4.065,6	4.278,4	4.486,5

Eksportet në vitin 2018 arritën një vlerë prej rreth 3.9 milionë ton, duke pësuar një rënie të lehtë prej 0,1 % krahasuar me vitin 2017. Ndikim më të madh në rënien e eksporteve të materialeve mjedisore e kanë dhënë “mineralet dhe koncentratet metalike”, eksportet e të cilave shënuan një rënie prej 9,7 %. Gjatë vitit 2018 ka patur rritje të eksporteve për të gjitha kategoritë e tjera të materialeve mjedisore, përkatësisht materialet fosile të energjisë me 6,4 %, “biomasa” me rreth 1,2 % dhe “mineralet jo metalike” me 1,1 %.

Tab. 3 Eksportet e materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Biomasa	248,2	333,3	331,2	369,1	373,5
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.525,6	1.345,1	1.242,1	1.262,6	1.140,2
Mineralet jo metalike	1.424,8	1.232,3	1.266,4	1.459,0	1.475,0
Materialet fosile të energjisë	1.225,9	1.205,9	997,2	712,6	758,3
Produkte të tjera dhe mbetje të eksportuara	108,6	127,5	122,2	144,7	196,5
Totali	4.533,2	4.244,1	3.959,0	3.947,9	3.943,5


Bilanci fizik tregtar i cili tregon diferencën midis importeve dhe eksporteve për të gjithë kategoritë e materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 543 mijë ton për vitin 2018, duke pësuar rritje me rreth 212,5 mijë ton, krahasuar me vitin 2017. Siç mund të vërehet në Figurën 2, produktet e “biomasës”, “materialeve fosile të energjisë” dhe “produktet e tjera dhe mbetjet” kanë bilanc tregtar pozitiv ndërsa produktet “mineralet jo metalike” dhe “mineralet dhe koncentratet metalike” kanë bilanc tregtar negativ, për vitin 2018.

Tab.4 Bilanci fizik tregtar

(mijë ton)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Bilanci Fizik Tregtar	-505,1	-298,4	106,6	330,5	543,0
Import	4.028,1	3.945,7	4.065,6	4.278,4	4.486,5
Export	4.533,2	4.244,1	3.959,0	3.947,9	3.943,5

Fig.2 Bilanci fizik tregtar



(mijë ton)


Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat sasinë totale vjetore të lëndëve të para që nxirren nga mjedisi, duke marrë në konsideratë dhe bilancin fizik tregtar. Në 2018 përdorimi i brendshëm arriti vlerën e rreth 22,9 milionë ton, 5,5 % më shumë, krahasuar me vitin 2017. Sipas strukturës së tij shohim që pjesën më të madhe të përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore e zënë “mineralet jo metalike” me 45,8 %, më pas vijnë produktet e “biomasës” me 39,5 %, “materialet fosile të energjisë” me 7,6 %, “mineralet dhe koncentratet metalike” me 6,6 % dhe “produkte të tjera” me 0,5 %.

Tab.5 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Biomasa	8.878,1	8.870,6	9.104,8	9.173,5	9.062,4
Mineralet dhe koncentratet metalike	694,1	1.000,5	690,3	924,1	1.509,4
Mineralet jo metalike	11.780,5	14.958,8	17.566,5	10.089,2	10.505,5
Materialet fosile të energjisë	1.161,4	1.158,6	1.055,1	1.405,3	1.736,9
Produkte të tjera dhe mbetje	168,0	138,9	160,0	157,5	122,5
Total	22.682,0	26.127,3	28.576,7	21.749,6	22.936,8

Fig.3 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore, 2018



Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë në vitin 2018 ishte rreth 8 ton, duke treguar një rritje me afërsisht 5,7 %, krahasuar me vitin 2017, e cila kishte një vlerë rreth 7,6 ton.

Tab.6 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë

(ton / banor)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Biomasa	3,1	3,1	3,2	3,2	3,2
Mineralet dhe koncentratet metalike	0,2	0,3	0,2	0,3	0,5
Mineralet jo metalike	4,1	5,2	6,1	3,5	3,7
Materialet fosile të energjisë	0,4	0,4	0,4	0,5	0,6
Produkte të tjera dhe mbetje	0,1	0,0	0,1	0,1	0,0
Totali	7,9	9,1	9,9	7,6	8,0

Metodologjia

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është një nga modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare.

Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore ka për objekt kryesor të përshkruaj lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ajo përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim.

Këto të dhëna janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rrethnesh/cilësia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Disa nga kategoritë kryesore dhe indikatorët kryesorë të llogarive të flukseve të materialeve mjedisore janë:

Biomasa

Biomasa përfshin materialet organike jo fosile me origjinë biologjike. Sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore, lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin të gjithë produktet bujqësore, peshqit dhe kafshët e gjuetisë. Blegtoria dhe produktet blegtorale (si p.sh qumështi, mishi, vezët) nuk përfshihen në këtë kategori.

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike të përpunuara dhe të pa përpunuara janë dy grupe kryesore në kategoritë e materialeve mjedisore, sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore, që përbëhen nga prodhimet e minierave, industria e ndërtimit dhe mineralet industriale.

Materialet Fosile të Energjisë

Përfshijnë burimet e naftës dhe materialet e tjera fosile të energjisë që janë formuara në të kaluarën gjeologjike, nga biomasa. Ato përfshijnë lëndet e ngurta, lëngjet dhe gazet.

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin sasinë vjetore të lëndëve të para (me përjashtim të ujit dhe ajrit) të nxjerra nga mjedisi natyror për t'u përdorur në ekonomi, për qëllime ekonomike.

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat shumën vjetore të lëndëve të para të nxjerra dhe të përdorura në ekonominë kombëtare, plus të gjitha importet fizike, minus të gjitha eksportet fizike.

Bilanci i Fizik Tregtar

Bilanci fizik tregtar është i barabartë me importet fizike minus eksportet fizike.

Burimi i të dhënave

Te dhënat e përdorura për Llogaritë e flukseve të Materialeve Mjedisore kanë burim të dhëna administrative të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Instituti i Statistikave (INSTAT) etj.

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me rregulloren (BE) Nr 691/2011 mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore dhe manualeve të Eurostat.